



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATË

Përpiluar më 22.07.2024

Komuna e Lipjanit, përfaqësuar nga Drejtori i Prokurimit Bekim Shabani në vazhdim (përmendët) Autoriteti kontraktues dhe

“G.I.Grafo – Loni SH.P.K”, të cilën e përfaqëson Nazim Pireva, në vazhdim do të përdoret (Kontraktuesi) në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Furnizimi me libreza, kartona dhe xhepa për bibliotekë,

me numër identifikues:

Nr i brendshëm	613-24-7298-1-4-7
----------------	-------------------

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e furnizimeve në vijim:

1.3 Afati kohor i kryerjes së shërbimeve do të realizohet mbrenda 5 diteve prej nënshkrimit të kontrates

1.4 Vendi i *ekzekutimit të furnizimeve* - **Furnizimi me libreza, kartona dhe xhepa për bibliotekë.**

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)	Çmimi Total
1.	Kartelat e lexuesit	Copë	500	0.25	125.00
2.	Librezë e antarësisë	Copë	500	0.05	25.00
3.	Kartelet e librit	Copë	3000	0.05	150.00
TOTALI:					300.00

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 300.00 €;

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetnija pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të kryhet pas përfundimit të furnizimeve, për të cilin do të hartohet raport nga menaxheri i kontratës.

Nëse kontraktuesi dështon në furnizim nuk do të paguhet.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve **me libreza, kartona dhe xhepa për bibliotekë**, duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë. (Shkuarja dhe ardhja e nxënësve duhet të jenë në kohë siç është specifikuar në nenin 1.1 të kësaj kontrate). Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 25% të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, kryerjen e furnizimeve, Menaxher i kontratës caktohet Uran Qeriqi .

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi të konstatojë se ka dështuar në realizimin e kontratës ditën të cilën është caktuar kryerja e furnizimeve, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk

arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës




12.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

12.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nazim Pireva	Emri:	Bekim Shabani
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.07.2024	Data:	22.07.2024
Vula:		Vula:	